



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.99/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), paraqitur kundër koalicionit Socijal Demokratska Unija (SDU)- Nasa Iniciativa, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen më datë 12.10.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), Anr.99/2025 e datës 03.10.2025.

II. Subjektit politik Socijal Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 3.000.00 (tremijë euro).

III. Detyrohet Subjektit politik Socijal Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 03.10.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), në të cilën pretendohet se më datë 02.10.2025, gjatë fushatës elektorale, kandidatja e koalicionit SDU-Nasa Iniciativa, për Komunën e Prizrenit, Duda Balje dhe Admir Alijli, përmes publikimeve në rrjetin social facebook morën pjesë në hapjen e projekteve infrastrukturore të financuara nga buxhet i Komunës së Prizrenit duke i keqpërdorur në këtë mënyrë institucionet e shtetit për promovimin e tyre personal .Tutje, kanë shtuar se në fotografi shihen kandidatet si dhe vet kryetari i Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, duke e krijuar kështu përshtypjen e identifikimit politik me mjetet dhe aktivitete të organeve shtetërore. Në ankesë theksohet se këto publikime janë shpërndarë edhe në profilet zyrtare të Duda Balje si dhe të Social Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa,

dhe se kjo është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë si dhe Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Si provë në ankesë kanë bashkëngjitur fotografi.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.02.2025, të Socijal Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, e refuzojnë në tërësi ankesën e paraqitur nga NDS, duke theksuar se këtu behet fjale për renovimin e ambulantes në Skrobisht, e që ngjarja nuk ka qenë mbledhje politike apo promovim i ndonjë partie, as në mbledhje nuk u përmenden numrat e partisë për votim apo numrat e kandidatëve, por ishte thjeshtë një tubim i komunitetit lokal i cili dëshironte të shënonte përfundimin e punimeve. Tutje në përgjigje në ankesë theksohet se as Duda Balje dhe as Admir Alijli nuk janë pjesë e pushtetit ekzekutiv në Komunën e Prizrenit dhe nuk kanë asnjë rol në marrjen e vendimeve në projektet infrastrukturore, dhe që as nga ana e tyre nuk është përmendur se ata janë përgjegjës për realizimin e ndonjë projekti, dhe se prania e tyre në Skrobisht ka qenë në cilësinë e pritësve me banorë të fshatit dhe jo në cilësinë e zyrtarëve apo të përfaqësuesve. Tutje në përgjigje në ankesë theksohet se sa i përket publikimit ai nuk buron nga profilet e kandidatëve por nga televizioni lokal TV Prizreni. Si përfundim kanë theksuar se kjo ka qenë një ngjarje e organizuar nga banoret dhe jo nga partitë politik duke kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i fotografive në rrjetin social facebook, nga subjekti politik Socijal Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, është vërtetuar se ka bërë fushatë duke vizituar dhe zhvilluar një takim me punonjës të Ambulantes të Mjekësisë Familjare. Nga provat materiale të bashkëngjitur ankesës, së Subjektit Politik Nova Demokratska Stranka (NDS), dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se subjekti politik Socijal Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, ka shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme LZP, konkretisht neni 36 paragrafi 1, 2, dhe 3, i cili përcakton: *“1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje 2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik 3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik”* Përveç kësaj, me nenin 5 par 2, pika 2.1 Rregulla

Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, është përcaktuar se: *Të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike, gjatë orarit të rregullt të punës, përveç kandidatëve të certifikuar, të cilët pezullojnë vendin e punës*” PZAP vlerëson se koalicioni Socijal Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, përkatësisht kandidatja për kryetare Duda Balje dhe kandidati Admir Alijli ka shkel rregullat e sipërcituara kjo pasi që kanë përdorë objektin publik të Ambulantes të Mjekësisë Familjare me qëllim të promovimit të kandidaturës së tyre për deputet.

Gjithashtu Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes. Kjo konsiston në faktin se subjekti politik Sociajl Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e fotografisë në rrjetin social facebook nga subjekti politik Sociajl Demokratska Unija (SDU) - Nasa Iniciativa, për fushatë zgjedhore ku është shfrytëzuar objekti publik dhe, është në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 36 paragrafi 1, 2, dhe 3 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.99/2025 më datën 06.10.2025

Kryesuesi i Panelit
Kujtim Pasuli



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.